



Aleanca për
Media
Etike

VENDIM Nr.34

Ankuesi: Z. Xhavit Dauti

Kundër: Emisionit "Piranjat"

Titulli i emisionit objekt ankimi:

Dhunuan të renë në Librazhd, por si reagojnë dhunuesit kur përballë kanë "Piranjat"

Vjegëza e emisionit objekt ankimimi:

<https://youtu.be/fplQm8xggVw>

Bordi i Aleancës për Media Etike pasi shqyrtoi ankesën,

KONSTATOI



Aleanca për
Media
Etike

Ankesa nuk ka ardhur nga personat e prekur drejtpërdrejtë që janë paraqitur në video, por nga palë e tretë. Rregullorja e Bordit thotë se, Bordi nuk merr në shqyrtim ankesa që vijnë nga palë të treta me përjashtim të rasteve kur ankesa përbën një interes publik.

Për rastin në fjalë Bordi ra dakord se ankesa përbën një interes publik dhe e mori në shqyrtim. Duke qenë se ankesa nuk ka ardhur nga personat e prekur drejtpërdrejtë, Bordi nuk mund t'i kërkojë emisionit "Piranjat" të marrë masa për fshirje apo që gazetarja të kërkojë falje publike, por Bordi mund t'i japë disa sugjerime emisionit në emër të opinionit publik.

Mbështetur në këto arsye, Bordi,

VENDOSI

T'i sugjerojë emisionit "Piranjat" jetë më i kujdesshëm në raste kaq delikate dhe që kanë interes publik. Gazetarja është treguar e dhunshme dhe ka marrë përsipër funksione dhe role që nuk i ka. Dhuna që shkaktohet ndaj gruas në video në njëfarë mënyre shkakton traumë tek publiku për këtë arsye duhet treguar kujdes në raste të tilla.

Gjithashtu i sugjerohet gazetares të mos dalë nga roli i saj dhe të bëhet gjykuese apo të përdorë një gjuhë bullizuese. Gazetarja duhet të bëjë investigim, por jo duke sulmuar. Gazetarja ka shfaqur një sjellje jo etike duke e terrorizuar personin në video, duke shfaqur kështu një mungesë profesionalizmi.